Vendndodhja e pikës së shkarkimit rrjetin e kanalizimeve	
Koordinatat (për efekt të vlerësimit të ndikimit)	
Emri i kompanisë e cila menaxhon sistemin e grumbullimit të ujërave të ndotura	
A është sistemi i kanalizimeve i lidhur me një impiant trajtimi?	
Emri i mjedisit përfundimtar uJOR pritës të ujërave të ndotura nga rrjeti i kanalizimit (estuar, lumë ose mjedis tjetër uJOR pritës dhe ndikimi në të i cili duhet kontrolluar)	

**Nuk ka shkarkime.**

**Informacion i detajuar mbi shkarkimet:**

<b>(1)Sasia e shkarkuar</b>			
Sasia Mesatare/ditë	m <sup>3</sup>	Sasia maksimale/ditë	m <sup>3</sup>
Sasia Mesatare/orë	m <sup>3</sup>		

(1) Jepni periudhën ose periudhat kur ndodhin shkarkimet duke përfshirë variacionet ditore ose sezonale (jepni informacion se kur ka qënë vënia në punë dhe/ose ndërprerja e punës):

<b>Periudhat e shkarkimit (mesatare)</b>	min/orë	orë/ditë	ditë/vit
--	---------	----------	----------

**Tabela 6.4.2:** Shkarkimet në kanalizime/rrjetin e kanalizimeve – Karakteristikat e shkarkimeve (një tabelë për çdo pikë shkarkimi)

Numri Referues i pikës së shkarkimit: \_\_\_\_\_

Parametri	Përpara trajtimit				Tek vendi i shkarkimit në mjedisin ujqor pritës				Efiçienca e pajisjes së trajtimit (%)
	Vlera mesatare maks. në orë (mg/l)	Vlera ditore e mesatare s maks. (mg/l)	kg/ditë	kg/vit	Vlera mesatare maks. në orë (mg/l)	Vlera ditore e mesatare maks. (mg/l)	kg/ditë	kg/vit	

## 6.5 SHKARKIMET NË TOKË

Për shkarkimet në tokë duhet të plotësohen Tabelat 6.5.1 dhe 6.5.2.

Përshkruani sistemet dhe procedurat për të parandaluar ose reduktuar çlirimet e ndotësve në mjediset e ujërave nëntokësorë, si dhe procedurat për parandalimin e ndikimeve negative në mjediset e ujërave nëntokësorë.

Kërkuesi duhet të japë informacion mbi llojet e substancave (mbetje bujqësore ose jo-bujqësore) që do të shpërndahen në tokë (mbetje llumrash, hi, mbetje të lëngshme, etj.) si dhe sasinë e propozuar, periudhat dhe metodën e shpërndarjes (tub i shkarkimit, rezervuar, çisternë).

Çdo pikë shkarkimi ose zonë shkarkimi duhet të tregohet në hartën e instalimit.

Të gjitha informacionet përkatëse duhet t'i bashakëngjiten këtij formulari në **Aneksin 6**.

**Shkarkimet ne toke jane minimale ose nuk ekzistojne pasi mikseri qe perdoret per recepturat e perzierjes se materialeve eshte elektronik dhe drejtohet nga kabina e komandimit me saktesi shume te madhe te sasive te, bitumit, cakellit dhe aditiveve. Uji qe perdoret per larjen e shesheve dhe makinerive ne sasi, derdhet ne gropen septike aty prane me permasa 4 x 5,e cila eshte e ndertuar me mure betoni 30 cm ndersa baza e saj eshte ndertuar me nje shtrese betony prej 50 cm. Gropa eshte e pajijur edhe me dekantues dhe per rrjedhoje eshte e papershkueshme. Behen vetem larje te thjeshta te dyshemese dhe territorit. Kjo sasi uji qe hidhet ne ambientet e punes largohet nepermjet procesit te avullimit ne pjesen me te madhe.**

**Tabela 6.5.1:** Shkarkimet në tokë (një tabelë për çdo pikë shkarkimi)

**Pika e shkarkimi ose zona e shkarkimit:**

Harta referuese e instalimit, Nr.	
Nr. ref. i pikës së shkarkimit ose zonës së shkarkimit	
Mënyra e çlirimit: (puset, shtresat e depërtueshme, spërkatja/lagia, përhapja, etj.)	
Vendndodhja	
Koordinatat sipas sistemit GAUS KRUGE: 1942_GK_ZONE_4	
Lartësia e shkarkimit/çlirimit (në lidhje me lartësinë nga mjedisi pritës )	
Klasifikimi i ujit të mjedisit ujqor pritës mjedisit i ujërave nëntokësorë): (nëse është i disponueshëm)	
Vlerësimi i ndjeshmërisë së ndotjes të mjedisit të ujërave nëntokësorë (përfshirë dhe shkallën e ndjeshmërisë)	
Identiteti dhe distanca e burimeve të ujërave nëntokësore në rrezik nga ndikimet negative prej shkarkimeve (puset, burimet, etj.)	
Identiteti dhe distanca e mjediseve ujore sipërfaqësore në rrezik nga ndikimet negative prej shkarkimeve	

**Informacion i detajuar mbi shkarkimet:**

<b>(1) Sasia e shkarkuar</b>			
Mesatare/ditë	m <sup>3</sup>	Sasia Maksimale/ditë	m <sup>3</sup>
Sasia Maksimale/orë	m <sup>3</sup>		

(1) Jepni periudhën ose periudhat kur ndodhin shkarkimet duke përfshirë variacionet ditore ose sezonale (jepni informacion se kur ka qënë vënia në punë dhe/ose ndërprerja e punës):

<b>Periudhat e shkarkimit (mesatare)</b>	<b>min/orë</b>	<b>orë/ditë</b>	<b>ditë/vit</b>
--	----------------	-----------------	-----------------



**Tabela 6.5.2:** Shkarkimet në tokë – Karakteristikat e shkarkimeve (një tabelë për çdo pikë shkarkimi)

Numri Referues i pikës së shkarkimit: \_\_\_\_\_

Parametri	Përpara trajtimit				Tek vendi i shkarkimit në mjedisin pritës				Eficienca e pajisjes së trajtimit (%) kg/ditë
	Vlera mesatarja maks. në orë (mg/l)	Vlera ditore e mesatares maks. (mg/l)	kg/ditë	Vlera mesatarja maks. në orë (mg/l)	Vlera ditore e mesatares maks. (mg/l)	kg/ditë	Vlera mesatarja maks. në orë (mg/l)	Vlera ditore e mesatares maks. (mg/l)	

## 6.6 SHKARKIMET E ZHURMËS

Jepni informacion të detajuar mbi burimet (vendndodhjen, natyrën, nivelin, periudhën ose periudhat e shkarkimit) e zhurmës që është gjeneruar ose do të gjenerohet.

Tabela 6.6.1 duhet të përmbajë informacion për secilin burim shkarkimi. Çdo burim shkarkimi i zhurmës duhet të shënohet qartë në hartën e instalimit.

Dokumentacioni mbështetës duhet të përfshihet në **Aneksin 6**.

**TABELA 6.6.1:** Shkarkimet e zhurmës – Përmbledhje e listës së burimeve të shkarkimit të zhurmës

Burimi i shkarkimit	Nr. Ref. i pikës së shkarkimit	Koordinatat sipas sistemit GAUS KRUGE: 1942_GK_ZONE_4	Nr. Ref. i pajisjes që gjeneron ndotje aklustike	Presioni akustik <sup>1</sup> (dBA) duke ju referuar distancës	Periudha e shkarkimit
Mjetet e Transportit (kamionat)	Z-1	<b>X=4391488.679</b> <b>Y= 4533262.444</b>	730-D107	55-60 dB	Ne periudha te shkurtera kohore
Impianti i prodhimit te asfaltobetonit	Z-2	<b>X=4391489</b> <b>Y= 4533243.387</b>	AC588	60-73 dB	Gjate orarit te punes

<sup>1</sup> Për segmente të ndryshme të instalimeve, mund të përdoren nivele të ndryshme të intesitetit të zhurmës.

## 6.7 VIBRACIONET

Duhet të përgatitet një informacion i detajuar për vibracionet, dhe nëse është e mundur, të paraqiten edhe informacionet që i përkasin vitit të kaluar.

Specifikoni dhe shënoni në hartë vendndodhjen e burimeve të vibracionit që mund të ndikojnë në mjedis, përtej ambienteve të instalimit dhe siguron rezultatat e matjeve ose llogaritjeve.

Burimet e vibracionit duhet të përfshijnë edhe transportin që bëhet brenda instalimit. Për instalimet e reja, duhet të merren në konsideratë të gjitha burimet e vibracionit gjatë ndërtimit dhe operimit të instalimit. Të gjitha burimet duhet të përshkruhen në shtojcat grafike.

Të gjithë dokumentat shtesë që kanë lidhje me sa u përmend më sipër, duhet të përfshihen në **Aneksin 6**.

**-Elektromotoret jane te fiksuar ne strukturen e impiantit, nuk ndikojne ne vibrim ndersa impianti prodhues eshte projektuar conform standardeve europiane duke minimizuar vibrimet ne maksimum. Nuk paraqesin problem per popullsine qe ndodhet perreth, as per punonjesit qe punojne aty.**

**Pajisjet janë te ekuilibruara në mënyrë të kënqeshme. Kjo fal konstruksionit dhe nivelit teknik të përgatitjes së tyre.**

## 6.8 REZATIMI JO-JONIZUES

Identifikoni burimet e rrezatimit jo-jonizues që kanë ndikim në mjedisin përtej ambienteve të instalimit dhe tregoni rezultatet e matjeve ose llogaritjeve të kryera për këtë qëllim. Burimet e rrezatimit duhet të tregohen qartë në hartën e instalimit.

**Nuk ka pajisje që punojnë me rrezatim. Energjia elektrike është e siguar në kablo.**

## 6.9 PËRSHKRUAJ GJENDJEN E VENDNDODHJES

Jepni të dhëna për gjendjen e mjedisit (ajrin, ujërat sipërfaqësorë dhe nëntokësorë, tokën, zhurmat, hidrologjinë, stabilitetin, speciet e mbrojtura etj.) që kanë lidhje me ndërtimin dhe vënien në punë të instalimit.

Bëni të njohur vlerësimin e ndikimit të gjithë shkarkimeve në mjedis, përfshirë edhe vendet/mjediset ku shkarkimet nuk janë çliruar ende.

Përshkruaj, ku është e nevojshme, masat për minimizimin e ndotjes në distanca të gjata dhe/ose në territorin e shteteve të tjera.

Të gjithë informacionet përkatëse duhet t'i bashkëngjiten këtij formulari me emërtimin **Aneksi 6**.

**Objekti ndodhet pranë kryqezimit të rrugës Lushnje Berat dhe Lushnje Fier , pranë vendit të njohur si Plasmasi. (Lushnje) rreth 510m në vijë ajrore nga ky kryqezim , rreth 500m larg qendrave të banuara dhe rreth 1.7km në vijë ajrore larg lumit Erzen.**

**Kjo Njesi Administrative me ndarrjen territorial është nën juridiksionin e bashkisë Lushnje, dhe përbehet nga keto fshatra.**

**Lushnja është një qytet në Shqipërinë qendrore. Ajo ka 58.200 banorë (2005) dhe është kryeqendra e rrethit të Lushnjës. Qyteti i Lushnjës shtrihet në lindje të fushës së Myzeqesë, buzë kodrave të Darsisë. Territori i tij zë një sipërfaqe prej 37 km<sup>2</sup>. Bashkia Lushnje numëron një popullsi prej rreth 60000 banorë. Qyteti është i ndarë në tetë lagje, të organizuara në pesë rajone.**

**Objektet e pushtetit vendor janë të vendosura në sheshin qendror, po këtu janë edhe institucionet kulturore artistike, historike, sportive etj. si: Kinoteatri, Muzeu Historik, Biblioteka Publike, Qendra Kulturore e Fëmijëve, Stadiumi etj. Instituti i Kërkimeve Bujqësore, tashmë me emërtim të ri, zhvillon prej dekadash një veprimtari të gjerë kërkimore-shkencore me dobi kombëtare. Katër vite më parë, aty u çel filiali i Universitetit Bujqësor të Tiranës. Gjithashtu këtu gjendet edhe shkolla e mesme bujqësore profesionale kombëtare, e cila është hapur dekada më parë. Përgjatë bulevardit kryesor, shtrihet lulishtja e madhe e qytetit. Sipërfaqe të gjelbërta ka edhe në brendësi të lagjeve. Vitet e fundit, rrugët e qytetit janë më të gjelbëruara me pemë dekorative të llojeve të ndryshme.**

**Lushnja ka një pozitë të favorshme gjeografike. Këtu kryqëzohen arteriet më të rëndësishme të komunikimit ndërqytetës. Autostrada veri-jug kalon pranë qytetit. Nga këtu nis edhe rruga më e rëndësishme e lindjes, Berat -Skrapar e më tej. Gjithashtu nëpërmjet rrugëve dytësore, Lushnja ka shkurtuar distancën me Elbasanin dhe qytetet e tjera të këtij qarku**

Në vitin 1920 në Lushnjë, u mbajt "Kongresi Kombëtar" që njihet në histori si Kongresi i Lushnjes, i cili i zhvilloi punimet nga data 21 deri më 31 janar. Në Kongres morën pjesë 54 delegatë të zgjedhur nga e gjithë Shqipëria dhe kjo është ngjarja e dytë më e rëndësishme për kombin shqiptar pas shpalljes së pavarësisë. Qëllimi i Kongresit ishte studimi i situatës së brendshme dhe të jashtme të vendit dhe masat që duhet të merreshin për shpëtimin nga reziku i copëtimit të Shqipërisë. Gjithashtu u propozua për të zgjedhur Tiranën si Kryeqytet i Shqipërisë.

Lushnja gjendet në perëndim të Shqipërisë, pikërisht në të ashtuquajturën Ultësira Perëndimore. Karakterizohet nga një relief i bute, me pjesën dërrmuese të sipërfaqes të zëna nga fusha dhe kodra të buta. Lushnja ka një pozicion të favorshëm gjeografik duke qenë një udhëkryq shumë i rëndësishëm, afër me portet kryesore të vendit, si dhe aeroportin e vetëm të vendit.

Demografia e qytetit të Lushnjës përbëhet nga një popullsi homogjene e përbëre nga vendas dhe të ardhur nga rrethet si Skrapar, Berat etj, komunitet Rome, Egjiptian etj. Popullsia është relativisht me transmetim të vlerave të larta shoqërore dhe edukate qytetare. Është krijuar një edukate për transmetimin e vlerave kulturore nga një brez në tjetrin duke i perfeksionuar ato. Një pjesë e popullsisë së Lushnjës ka emigruar në dy vende kryesore : Greqi dhe në Itali si dhe në vende të tjera. Ky projekt nuk sjell shkatërrim të rëndësishëm të habitateve natyrore. Zona paraqitet me një florë dhe faunë jo shumë të pasur. Nga ky aktivitet nuk demtohet flora dhe fauna e rrezikuara e percaktuar në VKM nr. 804 date. 4.12.2003 " Per miratimin e listës së specieve të flores Shqiptare , që vihen në mbrojtje" dhe e listuar në urdherin e Ministrisë nr. 146 date.8.5.2007 "Per miratimin e listës së kuqe të flores dhe faunes". Ndikimet negative mbi faunë do të jenë të ndryshme, mbi klasa të ndryshme të saj. Po të referohemi pasurisë së zonës në faunë del se klasa që ka ndikim të rëndësishëm është ajo e zvarranikeve, por specie që do të preken janë të pa rëndësishme dhe nuk figurojnë ndër ato të rrezikuara, mbrojtura endemike apo kërcënuara. Nuk pritet ndryshim i ekosistemit pasi shoqëria është dhe do të tregohet mjaft e kujdeseshme në zbatimin e teknologjive dhe metodave për prodhimin e asfaltbetonit si dhe do të jetë e gatshme të zbatojë të gjitha masat që do të rekomandohen për uljen e ndikimit. Ndërsa për të menjauar erozionin nga ujërat e rreshjeve atmosferike në perimetrin përreth objektit do të ndërtohen kanale dhe kuletat që ujërat të drejtohen në zona që nuk demtojnë tokën si dhe habitatet e flores dhe faunes së zonës.

Gjate zhvillimit të projektit nuk priten ndryshime të dukshme klimaterike, si në drejtim të permiresimit ashtu edhe në atë të perkeqesimit të saj. Nuk do të ketë ndryshime në temperaturë, në drejtim të erës, në sasinë e reshjeve. Për kryerjen e këtij aktiviteti nuk ndikon fare në kushtet klimaterike të kësaj zone.

Përsa i përket ndikimeve ekonomike ky projekt do të sjell efekte direkte në punësimin e popullsisë së zonës gjatë funksionimit të tij , pra do të rrisë tregun e punës si rrjedhim do të rritet edhe mirëqenia e nivelit të jetesës të popullsisë së zonës. Duke qenë një aktivitet i prodhimit, tregtimit dhe shpërndarjes së asfalto-betonit që është një element që i vjen në ndihmë industrisë së ndërtimit.

Zona ku do të zbatohet projekti nuk njihet si zonë e mbrojtur me vlera arkitektonike dhe kulturore, pra nuk kemi ndryshime apo demtime të saj duke qenë se nuk ekziston në këtë territor. Aktiviteti që do të zhvillohet nuk prek zonat turistike, zona të mbrojtura, zona arkeologjike, arkitektonike, objekte të trashëguara dhe të ndërtuara nga njeriu me rëndësi historike, sepse në këtë zonë ato nuk ekzistojnë. Është për t'u theksuar se në këtë zonë nuk ka monumente kulturore, zona arkeologjike dhe gjeomonumente.

#### Vlerësimi i Ndikimit të Shkarkimeve në Ajër

Përshkruani gjendjen aktuale të cilësisë së ajrit duke i kushtuar vëmendje të veçantë standardeve për cilësinë e ajrit.

Tregoni nëse shkarkimet në ajër mund të shkaktojnë dëme apo ndikojnë negativisht në mjedis, pavarësisht se mund të jenë brenda vlerave kufi të siguruara nga aplikimi i teknikave më të mira të disponueshme (TMD). Nëse vërehet erë e pakëndshme jashtë ambienteve të instalimit, duhet të bëhet një vlerësim i erës së pakëndshme, duke patur parasysh shpeshësinë/frekuencën dhe vendndodhjen e shfaqjes së saj.

Jepni informacion të detajuar mbi vlerësimin e ndikimit të shkarkimeve ekzistuese apo të parashikuara në mjedis, duke përfshirë edhe vendin/mjedisin në të cilin nuk janë çliruar ende shkarkimet.

Përfshini në **Aneksin 6** modelet e shpërndarjes së shkarkimeve në ajër, të krijuara nga proceset e ndryshme në instalim. Të gjitha modelet dhe informacionet e tjera që kanë lidhje me sa më sipër, duhet të përfshihen në **Aneksin 6**.

**Referuar natyres se procesit nuk ka sasi gazesh te emetuara ne atmosfere por vetem perhapje te pluhurit te krijuar nga levizja e automjeteve qe eshte prezente ne shesh gjate kohes se thate nga levizja e mjeteve ne kohen e ngarkimit te materialit ne bunkeret e depozitimit. Per shmangien e pluhurit behet sperkatje me uje her pas here ne sheshin e punes sidomos ne kohe te thate dhe me ere si dhe hermetizim sa me i mire ne linjen e furnizimit nga silloset ne perzieres. Gazet prej mjeteve jane ne interval kohore te shkurtera e pa ndonje ndikim ne mjedisin perreth.**

#### 6.10. VLERËSIMI I NDIKIMIT NË UJËRAT SIPËRFAQËSORË

Për të kryer vlerësimin e ndikimit në ujërat sipërfaqësorë, duhet respektuar kuadri ligjor në fuqi, për:

- Substancat e rrezikshme dhe të dëmshme të shkarkuara në ujë, si dhe klasifikimi kombëtar i mjediseve ujore dhe ujërave bregdetare;
- Kushtet për shkarkimin e ujërave të ndotura në kanalizimet publike;
- Kushtet për shkarkimin e ujërave të ndotura në ujërat sipërfaqësorë;
- Klasifikimi i ujërave dhe rrjedhave ujore.

Për këtë vlerësim duhet të plotësohet Tabela 6.10.1.

Tregoni nëse shkarkimet në ujërat sipërfaqësorë, mund të shkaktojnë dëme apo ndikojnë negativisht në mjedis, pavarësisht se mund të jenë brenda vlerave kufi të siguruara nga aplikimi i teknikave më të mira të disponueshme (TMD).

Jepni informacion të detajuar për vlerësimin e ndikimit të shkarkimeve ekzistuese apo të parashikuara në mjedis, duke përfshirë edhe vendin/mjedisin në të cilin nuk janë çliruar ende shkarkimet.

Përfshini në **Aneksin 6**, informacionin e detajuar për vlerësimin si dhe informacionet e tjera që kanë lidhje me sa më sipër.

**Keto procese teknologjike nuk shoqerohen me shkarkime te lengeta te rrezikshme . Në këtë proces uji do të dozet dhe perzihet me inertet dhe çimenton ne sasine e kerkuar per prodhimin e betonit dhe si rrjedhim nuk do te kete uje qe te dale nga procesi teknologjik. Ajo sasi e paket e ujit qe mund te derdhet kalon ne vaska dekantuese dhe me pas i bashkohet linjes se shkarkimit. Ujerat qe dalin gjate larjes se autobetoniereve dhe reshjeve orientohen permes kanaleve perkatese ne vasken e dekantimit dhe me pas per ne mjedisin ujqor prites. Ne raste te vershimeve te ujrave siperfaqesore te reshjeve subjekti merr masat per drejtimin e tyre ne kanalizimeve ne ane te rruges.**

**Projekti nuk ndikon negativisht në modelin drenazhues të zones. Ai do të zbatohet vetëm në një sipërfaqe shumë të kufizuar dhe pa përdorim masiv të ujit. Zbatimi i projektit nuk çon në ndryshime hidrografike të nivelit të ujrave, të rrugëve ujore, të rrjedhjes të ujrave nëntoksorë dhe sipërfaqësorë etj. Ky projekt nuk ka ndikim në hidrologjinë bregdetare për shkak se ndodhet larg vijes bregdetare.**

**Nuk ka shkarkime që depertojnë në rrjetin e kanalizimeve. Prodhimi i asfalto-betonit realizohet nga përzierja e përbërësve të tij, konkretisht të inerteve të fraksionuara si inerte të fraksionuara guri, bitum dhe aditive që nuk e ndotin mjedisin rrethues. Procesi i prodhimit të asfalto-betonit është proces i cili nuk ka mbetje teknologjike. Gjithashtu procesi teknologjik që zhvillohet është proces i mbyllur i cili nuk ka shkarkime sepse bazohet në miksimin e recepturave të sakta në impiantin e prodhimit.**

**Në funksion të nevojave të objektit të shërbimit do të përdoret rrjeti ekzistues i kanalizimeve. Sistemi i evakuimit të ujrave të zeza për vetë karakteristikat e kanalizimeve të zones do të jetë një sistem unitar. Perberja e ujrave të zeza nga destinacioni që ka zona do të jenë ujera komunale, të dalë nga objekti. Normat e përdorimit të ujit për aktivitetin do të përcaktohen nga destinacioni i përdorimit të ambienteve të shërbimit, pas miratimit përfundimtar të projektit. Evakuimi i ujrave atmosferike do të realizohet me anë të sistemit të kunetave dhe pusëve të vendosura në anet e rrugëve.**

**Tabela 6.10.1:** Cilësia e ujërave sipërfaqësorë

**Vendndodhja e monitorimit/** Koordinatat sipas sistemit GAUS KRUGE: 1942\_GK\_ZONE\_4: \_\_\_\_\_

Parametri <sup>1</sup>	Rezultatet (mg/l)				Metoda e marrjes së mostrës (automatike, rrymë e vetme, përbërja e rrymës, etj.)	Qëllimi i vlerësimit analitik	Metoda analitike/ teknika
	Data	Data	Data	Data			

<sup>1</sup> Renditni të gjithë parametrat e detyrueshëm dhe parametrat specifik të instalimit/impianitit. Nëse është e nevojshme, shtoni rreshta të tjerë.

#### **6.11. VLERËSIMI I NDIKIMIT TË SHKARKIMEVE NË RRJETIN E KANALIZIMEVE**

Jepni informacion të detajuar për vlerësimin e ndikimit të shkarkimeve ekzistuese apo të parashikuara në mjedis, duke përfshirë edhe vendin/mjedisin në të cilin nuk janë çliruar ende shkarkimet.

Përfshini në **Aneksin 6**, informacionin e detajuar për vlerësimin si dhe informacionet e tjera që kanë lidhje me sa më sipër.

#### **6.12. VLERËSIMI I NDIKIMIT TË SHKARKIMEVE NË UJËRAT NËNTOKËSORË**

Përshkruani gjendjen aktuale të cilësisë së ujërave nëntokësorë, në përputhje me klasifikimin e mjediseve ujore (rrjedhave ujore, etj.) dhe ujërave bregdetare në Shqipëri.

Për këtë duhet plotësoni Tabelën 6.12.1.

Jepni informacion të detajuar për vlerësimin e ndikimit të shkarkimeve ekzistuese apo të parashikuara në mjedis, duke përfshirë edhe vendin/mjedisin në të cilin nuk janë çliruar ende shkarkimet. Informacioni duhet të përfshijë edhe përhapjen në sipërfaqe, injektimin në tokë, etj.

Përfshini në **Aneksin 6**, një informacion të detajuar mbi vlerësimin, duke përfshirë raportin hidrologjik, të dhënat mbi cilësinë e ujit, klasifikimet e shtresës së depërtueshme, ndjeshmërinë, identifikimin dhe zonimin e burimeve dhe rrjedhave ujore.

Kur shkarkimet janë çliruar direkt në/ose brenda tokës, duhet të ndërmerret një testim i cilësisë së tokës. Është e nevojshme të identifikohen të gjithë mjediset e ndjeshme ujore (si rezultat i shkarkimeve të sipërfaqes).

**Zbatimi i projektit nuk çon në ndryshime hidrografike te nivelit të ujërave, të rrugëve ujore, të rrjedhjes të ujërave nëntokësorë dhe sipërfaqësorë etj. Ky projekt nuk ka ndikim në hidrologjinë bregdetare për shkak se ndodhet larg vijes bregdetare.**



**Tabela 6.12.1:** Cilësia e ujërave nëntokësore

**Vendndodhja e monitorimit/** Koordinatat sipas sistemit GAUS KRUGE: 1942\_GK\_ZONE\_4: \_\_\_\_\_

Parametri <sup>1</sup>	Rezultatet (mg/l)				Metoda e marrjes së mostrës (hyrje, depozitë, etj.)	Qëllimii vlerësimit analitik	Metoda/teknika analitike
	Data	Data	Data	Data			

<sup>1</sup> Rënditni të gjithë parametrat e detyrueshëm dhe parametrat specifikë të instalimit. Nëse është e nevojshme, shtoni rreshta të tjerë.

**Cilësia e Ujërave nëntokësorë (Lista 2 e 2)**

Parametri <sup>1</sup>	Rezultatet (mg/l)				Metoda e marrjes së mostrës (hyrje, depozitë, etj.)	Qëllimi i vlerësimit analitik	Metoda/teknika analitike
	Data	Data	Data	Data			
Niveli i ujit (mbi nivelin e detit)							

<sup>1</sup> Renditni të gjithë parametrat e detyrueshëm dhe parametrat specifikë të instalimit/impianitit. Nëse është e nevojshme, shtoni rreshta të tjerë.

### 6.13. NDOTJA E TOKËS/UJËRAVE NËNTOKËSORË

Jepni një informacion të detajuar mbi ndotjen e njohur aktuale ose të mëparshme të tokës dhe ujërave nëntokësore, në/ose afër vendit të instalimit.

Përfshini në **Aneksin 6**, të gjithë detajet, përfshirë studime kërkimore, vlerësime, raporte, rezultate monitorimi, dhe metodat për parandalimin e ndotjes, rehabilitimin, etj.

Jepni informacion për vlerësimin e ndikimit të rikuperimit dhe të asgjësimit të mbetjeve në instalim.

Përkruani masat e synuara në parandalimin e gjenerimit dhe rikuperimit të mbetjeve. Jepni një vlerësim të detajuar të ndikimit në mjedis të vendepozitimit/vendasgjesimit aktual apo të propozuar të mbetjeve, brenda territorit të instalimit, duke përfshirë edhe mjedisin në të cilin shkarkimet nuk janë çliruar ende.

Ky informacion duhet të përfshihet në **Aneksin 6**.

**Nuk gjenerohen ndotje të tokës dhe ujërave nëntokësore. Gjate procesit të prodhimit të asfalto-betonit sasia e inerteve përpara se të hidhet në impiant peshohet pra ajo është me mase të caktuar nuk ka shkarkime të tepërta në mjedis. Një sasi fare e vogël e mbetjeve nga puna në linjen e asfalto-betonit është rreth 0.5 % mase e cila riciklohet për ripërdorimin në linjen e përgatitjes së betonit. Përvoja i përket mbetjeve nga larjet e mjeteve të transportit të betonit sëbashku me sasinë e ujit që realizon larjen e tyre kalon në vasken e ndertuar për dekantim të masës së ngurtë ku qëndrojnë për një kohë të caktuar dhe më pas shkarkohen në mjedisin ujor prites.**

Subjekti realizon larjen në një vend të caktuar brenda sheshit të objektit por referuar gjendjes krahas arritjes kërkohet pastrim korrekt të kanalit të ujërave prej llumit të larjes së mjeteve dhe dherave të sheshit gjatë reshjeve.

### 6.14. NDIKIMI I ZHURMËS

Për të vlerësuar ndikimin e zhurmës, duhet të kryeni matjen e nivelit të zhurmës në mjedis. Paraqisni të dhënat e marra në Tabelën 6.14.1 sipas informacionit të renditur më poshtë:

- Specifikoni nivelin maksimal të zhurmës që mund të haset në pikat karakteristike brenda ambienteve të instalimit (specifiko intervalin e kohëzgjatjes së matjes);
- Specifikoni nivelin maksimal të zhurmës që mund të haset në pikat karakteristike të ndjeshme, jashtë ambienteve të instalimit;
- Siguroni informacion të detajuar për nivelin ekzistues të zhurmës, kur instalimi nuk është në gjendje pune, përkatësisht në mungesë të zhurmës nga operimi i instalimit.

**Aneksi 6** duhet të përfshijë modelin e përhapjes së tingullit dhe masat për kontrollin dhe shuarjen e zhurmës.

Burimet e zhurmave janë në sipërfaqe. Çdo burim përhap vlerë zhurmë. Fusha akustike që rezultojnë varet nga karakteristikat e absorbimit dhe reflektimit të të gjitha pengesave ekzistuese, ndërmjet burimit dhe receptorit. Shoqëria është kujdesur të importojë nga jashtë pajisje bashkohore dhe në gjendje të mirë teknike, në mënyrë të tillë që zhurmat të krijohen prej tyre të mos sjellin ndotje akustike dhe të jenë të demshme për mjedisin dhe shëndetin e punonjësve. Ndikimet e zhurmave gjatë fazës funksionale do të vijnë nga mjetet që do të sjellin lëndet e para në linjë, pajisjet e instaluar për perzierjen e agregateve për

**prodhimin e asfalto-betonit të gatshëm sipas markave të caktuara. Niveli i zhurmave të këtyre mjeteve transportuese është i atij niveli që nuk influencën si për të punësuarit dhe për banorët dhe gjallesat për rreth tij. Koha në të cilën do të jenë të pranishme këto zhurma është vetëm gjatë ditës, meqenëse në objekt do punohet vetëm me një turn. Niveli i zhurmave të këtyre mjeteve në largësi nuk do të jetë i madh dhe do të jetë konform normave në fuqi.**

**Tabela 6.14.1** Vlerësimi i zhurmës në mjedisit

	Koordinatat sipas sistemit GAUS KRUGE: 1942_GK_ZONE_4) (7 Veri, 6 Lindje)	Niveli i zhurmës /dB(A)		
		$L(A)_{eq}$	$L(A)_{10}$	$L(A)_{90}$
Ambientet e instalimit				
Vendndodhja 1:				
Vendndodhja 2:				
Vendndodhja 3:				
Vendndodhja 4:				
Vendndodhjet e ndjeshme të zhurmës				
Vendndodhja 1:				
Vendndodhja 2:				
Vendndodhja 3:				
Vendndodhja 4:				

Shënim: Të gjitha vendndodhjet duhet të shënohen qartë në hartat bashkëngjitur kësaj kërkesë

## 7. REDUKTIMI I SHKARKIMIT DHE SISTEMET E KONTROLLIT

Përshkruani masat ekzistuese/të propozuara, teknologjinë dhe teknika të tjera për të parandaluar shkarkimet, ose nëse nuk është e praktikueshme, për të reduktuar shkarkimet nga impianti/veprimtaritë.

Përfshini informacion mbi sistemet e reduktimit dhe kontrollit të shkarkimeve (shkarkimet në ajër dhe ujë së bashku me projektet korresponduese sipas Sipas Aneksit 2 të Udhëzimit të Kërkesës për Leje Mjedisit për kërkesit.

Për secilën pikë shkarkimi të identifikuar, plotësoni Tabelën 7.1.1 dhe jepni projektin për sistemin e reduktimit të shkarkimit.

Informacioni duhet paraqitur në **Aneksin 7**.

Masat zbutese të ndikimeve negative konsistojnë në marrjen e masave për uljen e ndotjeve gjate procesit të prodhimit të betonit, si të pluhurit në ajër, zhurmave, erozionet si dhe uljen e efekteve negative hapsinore në territor, faune dhe flore.

### **MASAT LEHTESUESE QE DO TE NDERMERREN GJATE USHTRIMIT TE AKTIVITETIT**

Masat zbutese të ndikimeve negative konsistojnë në marrjen e masave për uljen e ndotjeve gjate procesit të prodhimit të asfalto-betonit, si të pluhurit në ajër, zhurmave, erozionet si dhe uljen e efekteve negative hapsinore në territor, faune dhe flore.

### **MASAT NDAJ EROZIONIT**

Kjo zonë nuk ka predispozim të theksuar për erozion në sipërfaqen e tokës, ky fenomen është në nivele të paperfillshme. Për shmangien dhe parandalimin e erozionit të zonës ku do ndërtohet objekti dhe rrethinave përreth si dhe për ruajtjen e regjimit të rrymës së ujit të reshjeve dhe parametrave hidrodinamike të saj, në projekt është përcaktuar shfrytëzimi harmonik dhe i kombinuar në kohë dhe hapësirë të zonës në teresi. Në zonën ku do zhvillohet projekti hap pas hapi dhe në përfundim të aktivitetit, është parashikuar sistemimi dhe mbulimi i një sipërfaqeje të konsiderueshme me dhëra humusore dhe bimesi të zonës. Kjo sipërfaqe e përfutur nga trajtimet e mesiperme, do të japë mundësi për kultivimin e bimeve dhe pemëve të ndryshme, duke krijuar njëherësh kushte për parandalimin e erozionit dhe përmirësimin e pamjes së përgjithshme të zonës ku do ushtrohet aktiviteti.

### **MASAT PËR EMETIMET NË AJËR**

Aktiviteti "Linjë prodhim asfalto-betoni" nuk sjell emetime të gazeve në atmosferë sepse nuk perdore lende djegëse gjate zhvillimit të aktivitetit të tij prodhues. Lenda djegëse perdoret vetem nga mjetet e transportit të lendeve të para si dhe produktit përfundimtar. Për mbrojtjen nga gazet e motorreve diezel do të merren keto masa :

- 1- Mjetet motorrike do të jenë bashkëkohore që plotësojnë standartet shtetërore.
- 2- Ato do të jenë të pajisura në marmita me katalizatore për kapjen e gazeve toksike.

Procesi teknologjik ben peshimin e materialit inert per realizimin e markave te ndryshme te Betonit dhe asfalto-betonit. Ne te njejten kohe qe peshohet materiali inert ne peshoren tjetër peshohet çimentoja e cila vjen nga pika e furnizimit me bot. Sillosat jane te mbyllur ne menyre hermetike. Furnizimi behet me tuba gome . Ne linje eshte instaluar filtri i pluhurave te çimentos ne menyre qe pluhuri te mos dale ne atmosfere. Pra i gjithë procesi eshte nje cikel i mbyllur dhe nuk emeton pluhura. Persa i perket pluhurave qe krijohen gjate procesit te ngarkimit apo shkarkimit te lendeve te para nga ana e shoqerise ne menyre periodike sidomos ne kohe te thate do te behet lagia e territorit me uje per shmangien e pluhurit. Transportuesit jane prej gome te hermetizuar si dhe ne linje do te instalohen filtra per pluhurat ne menyre qe te mos ket emetim te tyre ne atmosfere. Punonjesit do te jene te pajisur me maskat perkatese per mbrojtjen ndaj tij. Perreth linjes do te behet sistemimi i ambientit per qellim mbrojtjen e peizazhit duke bere mbjelljen e pemeve me gjelberim te perhershem si dhe me lule dekorative. Nga ana e personelit te shoqerise do te tregohet nje kujdes i vecante per mirembajtjen e tyre.

## MASAT PER ULJEN NE MINIMUM TE ZHURMAVE

Burim zhurme është çdo makinë, instalim, mjet pune, mjet transporti, proces teknologjik, që lëshon zhurmë. Mbrojtja nga zhurma per zhvillimin e ketij aktiviteti duhet te sigurohet nga vet shoqeria aktiviteti te ciles e gjeneron ate. Masat e mbrojtjes nga zhurma përbëjnë tërësinë e ndërhyrjeve dhe të veprimeve, që merren ndaj burimit të zhurmës, si dhe në vendin e ndikimit të saj negativ, duke e sjellë atë në nivelin kufi.

Masat qe do te merren per minimizimin e zhurmave nga ana e shoqerise jane:

- Makinat e transportit dhe pajisjet gjate fazes se ndertimit do te jene bashkekohore qe plotesojne standartet shteterore, te pajisura ne marmita selenciatores te pakesimit te zhurmave.
- Per te ulur me tej ndikimin nga zhurmat punetoret detyrimisht do te perdorin paisjet e mbrojtjes ne pune “kufje”

## MASAT PER SHKARKIMET NE UJE

Sic eshte theksuar edhe me siper ky proces nuk shkarkon ne mjedis uhor prites ujera te ndotura nga procesi i prodhimit te betonit . Uji perdoret si element perzieres ne beton sipas recepturave te caktuara dhe nuk ka teprica te tij. Ujerat qe dalin gjate larjes se autobetonierëve dhe reshjeve orientohen permes kanaleve perkatese ne vasken e dekantimit dhe me pas per ne mjedisin uhor prites. Ne menyre periodike nga ana e shoqerise do te behet pastrimi i kanaleve orientues si dhe vaskes se dekantimit. Fraksionet e inerteve qe dekantohen aty rifuten ne procesin e prodhimit te betonit dhe asfalto-betonit. Per levizjen e ujerave te shiut eshte ndertuar sistemi i drenazhimit ndersa persa i perket ujerave te bardha dhe te zeza ato i bashkohen sistemit te kanalizimit te vendosur nga pushteti lokal.

## MASAT PER DEPOZITIMET NE TOKE

Sheshi i ndertimit ka shume pak vegjetacion. Nuk do te jete nevoja per levizje volumesh te medha dherash, pasi terreni eshte relativisht i sheshte.

Mbetjet e ngurta qe vijne si rezultat i projektit jane dherat qe rezultojne nga germimet e bera per nivelim te territorit per instalimin e linjes se prodhimit. Keto dhera depozitohen ne nje vend te vecante ne menyre qe te riperdoren per rehabilitimin e zones.

Gjate procesit të funksionimit ky aktivitet nuk gjeneron mbetje të ngurta në forme sterile të demshem për mjedisin, fraksionet e inerteve hidhen me masen e duhur në autobetoniere për procesin e perzierje së betonit, ndërsa masa e ngurte që dekonton në gropen dekantuese rifuten në proces. Mbetje të tjera të cilat dalin nga aktiviteti i përditshëm i punetoreve do grumbullohen në kontener dhe me pas largohen për në vendin e caktuar nga pushteti lokal zoned konform kërkesave të përcaktuara.

## MASAT ESTETIKE DHE EKOLOGJIKE

Në projektin e shfrytëzimit të linjes së prodhimit të asfalto-betonit do të merren masat estetike dhe ekologjike të cilat konsistojnë në rregullimin e ambjentit të jashtëm me peme dekorative dhe ullinj për të krijuar një ambjent të kënaqshëm për syrin e njeriut. Masat rehabilituese, në rast ndotje dhe dëmtimi të mjedisit

Masat për rigjenerimin e mjedisit do të konsistojnë në:

- a. kryerjen e të gjitha punimeve të domosdoshme momentale rehabilituese, sipas projektit.
- b. krijimin e sipërfaqeve me mbjellje.
- c. sistemimin e materialeve dhe të sterileve që vijnë nga kryerja e proceseve të punës, të planifikuara në projektin inxhinierik.
- d. mbjelljen e sipërfaqeve të gjelberuara e mirëmbajtjen e sipërfaqeve të mbjella, etj.

## RASTET AKSIDENTALE

Zbatimi i këtij projekti nuk do të sjell rrezikshmeri për aksidente, duke qenë se nuk do të ketë mbajtje ose përdorim i substancave të rrezikshme. Janë marrë masat për parandalimin e tyre, mjetet kontrollohen vazhdimisht për gjendjen teknike të tyre në mënyrë që të mos kemi rrjedhje lubrifikante apo karburant. Shoqëria siguron se do të ketë ndërhyrje të menjehershme nëse do të ketë ndikime negative në mjedis.

## RREZIQET ME PASOJA NË MJEDISIN HUMAN DHE EKONOMIK

- Aksidentet e punonjësve gjatë procesit teknik në objekt.
- Aksidentet si pasoje e rënies së zjarrit.

Probabiliteti i ndodhjes për secilin nga rastet e mësipërme do të varet shumë nga masat mbrojtëse që do të parashikohen dhe zbatohen. Zhvillimi i aktivitetit nuk shoqërohet me aksidente të cilat mund të sjellin pasoja të demshme në mjedis si ndotje të ujërave nga lende të rrezikshme, emetime në ajër nga gaze helmuese apo kontaminim të tokës.

## SIGURIMI TEKNIK DHE MBROJTJA NË PUNË

Aktiviteti "Linje asfalto-betoni" nuk përdor lende të demshme dhe të rrezikshme si për mjedisin ashtu edhe për punonjësit. Lendet e para që futen në proces nuk peshojnë ndryshime kimike. Për shmangien e aksidenteve nga pajisjet dhe makinerit tregohet një kujdes i veçantë nga punonjësit për mirëmbajtjen e gjendjes së tyre teknike si dhe zbatohen me rigorozitet kushtet e sigurimit teknik. Gjithashtu në mënyrë periodike punonjësit instruktohen për rreziqet në punë dhe masat e menyrat për parandalimin e tyre.

Për të krijuar një ambjent pune optimal dhe funksional shoqëria "Mared Konstruktion" shpk do të pajisë të gjithë punonjësit që do të punojnë në linjen e prodhimit të betonit dhe asfalto-betonit me uniformat dhe mjetet mbrojtëse përkatëse.



Regulloret e Teknikes se Sigurimit, nga ana e drejtuesit teknik dhe shoqerise , do te zbatohen ne cdo proces pune te percaktuar ne plan- organizimin e kryerjes se proceseve te punes tehartuar nga drejtuesi teknik i punimeve dhe te miratuar nga drejtuesit e shoqerise , i cili do te permbaje :

- Plan organizimi i punes hartohet nga drejtuesi teknik.
- Drejtuesi teknik i punimeve, ose personi i ngarkuar, do te beje kontrollin teknik per ecurine dhe mbarevajtjen sa me te mire te proceseve te punes.

Drejtuesi teknik i punimeve do te kryeje instruksione te rregullta mujore e tre mujore per punonjesit

## MASAT NDAJ ZJARRIT

